



REPUBLIKA E SHqipëRISE
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1476 Regj.
Nr. 1476/7 Prot.

Tiranë, më 24/12/2021

URDHËR

“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar : QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Per dijeni Debitor: NEW OPPORTUNITIES sh.p.k
Per dijeni kreditorit MVR sh.p.k

Pranë Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Privat “JUS” sh.p.k me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarrimore me numër Regj 1476 me palë:

Kreditor: SHOQËRIA “MVR” SH.P.K NIPT: L91609017K
Debitor: NEW OPPORTUNITIES NIPT: NUIS L71507037J
Objekti: Pagim faturash

Unë përmbarruesi gjyqësor Mario Hasanlliu pasi shqyrtova materialin e plotë të dosjes përmbarrimore:

KONSTATOVA:

Në titullin ekzekutiv: Vendimi nr. 17916 datë 16.12.2021 lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është përcaktuar detyrimi NEW OPPORTUNITIES NIPT: L71507037J si palë debitore ti paguaj kreditorit SHOQËRIA “MVR” SH.P.K NIPT: L91609017K shumën prej 4,346,000 (katër milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë në fatura të pashlyera, si dhe kamatëvonesat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi për Faturën Tatimore me Nr. 93639610 datë 16.09.2020, në vlerën 1.992.000 lekë, Faturën Tatimore me Nr. 93639616 datë 20.09.2020, në vlerën 1.998.000 lekë. Faturën Tatimore me Nr. 93639604 datë 03.09.2020, në vlerën e mbetur 356.000 lekë Kamatëvonesat për faturat e pashlyera janë llogaritur deri në datën 21.12.2021, nga ekspert kontabel i certifikuar, në vlerën **440.186 lekë** Tarifa përmbarrimore për shumën totale të detyrimit është në masën **382.895 lekë**. Tarifa për akt- përlllogaritjen e kamatvonesave është në masën **40.000 lekë**

Për këtë arsye :

Në bazë të neneve 519 te K.Pr.Civile, 527, 593 e në vijim të K.Pr.Civile e U. B. Sh "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në Banka"

URDHËROJ:

1- **Qendra Kombëtare e Biznesit** brenda 10-ditësh nga marrja dijani, të verifikojë nëse ekzistojnë kuota/aksione/aktive dhe biznese të regjistruara në emër të :

- **NEW OPPORTUNITIES NUIS L71507037J** me administrator *Shkëlqim Llaçi*
- **BLU COLOR SRL ALBANIA NUIS: L72412038S** me administrator *Shkëlqim Llaçi*

dhe nëse ka të tilla të kryejnë vendosjen e sekuestros mbi kuotat dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i kuotave për shumën e detyrimit prej: **5.209.081 (pesë milion e dyqind e nëntë mijë e tetëdhjetë e një) lekë**

2- Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3- Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në nenin 598 e në vijim te K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

PËRMBARUES GJYQËSOR

Mario HASANLLIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr.1476 Regj.
Nr 1476/6 Prot.

Tiranë, më 24/12/2021

SAKTËSIM URDHER “PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”
NR. 1476/ 5 PROT DATË 23/12/2021

Drejtuar: Bankave të Nivelit të II

Në vijim të Urdher “Për Vënien E Sekuestros Konservative” Nr. 1476 Prot Datë 23/12/2021 ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Pranë Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Privat “JUS” sh.p.k me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarrimore me numër Regj 1476 me palë: **Kreditor: SHOQËRIA “MVR” SH.P.K NIPT: L91609017K Debitor: NEW OPPORTUNITIES NIPT: NUIS L71507037J Objekti: Pagim faturash**

Bazuar në nenin 519, 594 të K.Pr.Civile urdhëroj vendosjen e sekuestros:

- në llogarinë e debitorit **NEW OPPORTUNITIES NIPT: NUIS L71507037J** në shumën **5.209.081 (pesë milion e dyqind e nëntë mijë e tetëdhjetë e një) lekë**
- Referuar urdhërit ekzekutiv: **Vendimi nr. 17916 datë 16.12.2021 lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë** ku është përcaktuar detyrimi i palës debitore.

Sekuestro të vendoset mbi shumën **5.209.081 (pesë milion e dyqind e nëntë mijë e tetëdhjetë e një) lekë** dhe për shumat, të cilat do të bëhen të disponueshme në të ardhmen në llogari, deri në plotësimin e kësaj shume.

Njoftimi i vendosjes së sekuestros të dërgohet brenda datës 29.12.2021

PËRMBARUES GJYQËSOR
Mario HASANLLIU

